# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-445911**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama në Napoli/ Viziton Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit “L’Orientale” (FOTOT) |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kulture/rama-ne-napoli-viziton-katedren-e-gjuhes-shqipe-prane-universitetit-lori-i586245` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 11:58:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 11:54:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8ccf271b9a8eefdc2544ce00ce675370317aa52b354b22373e420f8f28ffdaff` |
| TEKSTI | `d8eee1ce5648e420ad56be140a58e6f8255e99d4f827a641b67d9b54e2e50326` |
| PAMJA | `f9469aa29a7605f4e701894fdd7f493cf9ea9055edc3e036c352a5d0494fcf3d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `347eeaaeb56f1c6acec6880ef1745c616b106ddfca8d822e1ac0307e0f6d5507` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/347eeaaeb56f1c6acec6880ef1745c616b106ddfca8d822e1ac0307e0f6d5507`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rama në Napoli/ Viziton Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit “L’Orientale” (FOTOT)

TemA
15 Shtator 2026, 13:54Kulturë TEMA



Kryeministri Edi Rama ndodhet sot në Napoli, Itali, për të marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Konsullatës së Nderit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë ditës së sotme, kryeministri Rama vizitoi Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit “L’Orientale” të Napolit, një nga qendrat historike të studimeve albanologjike dhe njëkohësisht katedra më e vjetër e Gjuhës Shqipe, e themeluar nga Jeronim De Rada dhe intelektualë arbëreshë.

Kjo katedër mbart një traditë të rëndësishme në ruajtjen dhe promovimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare.

Në takimin me stafin akademik të universitetit, kryeministri Rama vlerësoi rëndësinë e kësaj tradite dhe theksoi nevojën për forcimin e bashkëpunimit dhe krijimin e një rrjeti më të strukturuar, që do të kontribuojë në ruajtjen, promovimin dhe pasurimin e mëtejshëm të studimeve dhe trashëgimisë shqiptare.

“Ta krijojmë një lloj rrjeti këtu në universitet, me idenë që më pas të mund të ndihmojmë në mënyrë më të strukturuar dhe gjithashtu ta përdorim për të ruajtur e për të shfrytëzuar më mirë gjithçka që prodhohet këtu”, u shpreh Kryeministri.

Në këtë vizitë ishte e pranishme edhe ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro. A.K./TemA

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Celine Dion "pushton" Parisin]

12:56 Kulturë

[Kush ishte Flora Brovina? Gruaja që e ktheu dhimbjen në poezi, mjekësi dhe qëndresë]

12:16 Kulturë / 1 koment

[Ka vdekur Flora Brovina, shkrimtarja dhe ish deputetja e Republikës së Kosovës]

11:51 Kulturë / 3 komente

[VIDEO+FOTO/ Dy shtete nuk ishin në luftë, por kufiri u bë front lufte për njeriun]

11:31 Kulturë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.